



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 1/2020

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Dega në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të Shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, Thyerje e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, të mbajtura më 29.11.2020, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Dega në Mitrovicë të Veriut, A.nr.1/2020 e datës 30.11.2020, ndërsa Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, i SHQIPTOHET gjobë në lartësi prej 20,000.00 euro, (njëzetmijë), në emër të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në ditën e votimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës e Veriut, të mbajtura me datë 29.11.2020.

II. Detyrohet Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datën 02.12.2020, ka pranuar ankesën Anr.1/2020, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Dega Mitrovicë e Veriut, e dorëzuar në Postën e Kosovës me datë 30.11.2020, me të cilën pretendon se me datën 29.11.2020, në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve në veri, Kryetari i Listës Serbe dhe njëkohësisht zëvendës kryeministri Goran Rakiç dhe deputeti Igor Simic, në një prononcim për media kanë bërë ndërhyrje në procesin zgjedhor, duke bërë thirrje të votohet Lista Serbe, dhe duke thyer heshtjen zgjedhore e cila është e rregulluar me ligjet e Kosovës.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e ka njoftuar Subjektin Politik Lista Serbe, për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 03.12.2020 deri në ora 13:00.

Në përgjigjen në ankesë Lista Serbe, thekson se këto pretendime të ankuesit janë absolutisht të pabazuara, sepse me datë 29.11.2020 Lista Serbe, nuk ka organizuar asnjë konferencë për media në kohen e heshtjes zgjedhore dhe në asnjë mënyrë me aktivitetet e saja nuk ka bërë shkelje të heshtjes zgjedhore, dhe se ankesa Anr.01-2020 e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje, nuk përmban detajet siç janë: kohen e saktë se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar e LZP-së, lokacionin e saktë ku ka ndodhur shkelja e Ligjit, deklaratën e saktë të shqiptuar me dëshmi se Goran Rakic, këtë e ka shqiptuar në të vërtetë, e kjo është obligim i parashtruesit të ankesës i cili parashtron ankesë në PZAP, duke u bazuar në nenin 5.7 të Rregullës Zgjedhore nr.02/2015. Me tutje në përgjigjen në ankesë theksohet se ankesa e parashtruar është e përgjithësuar dhe në kundërshtim me rregullat dhe procedurat e PZAP-it, ku subjekti politik Lista Serbe është akuzuar pa bazë, dhe është në kundërshtim me Rregullën

Zgjedhore nr.02/2015 edhe inicimi dhe fillimi i procedurës në bazë të ankesës Anr.01-2020, sepse me qasjen në materiale të cilat na i keni dërguar shihet se ankesa është parashtruar me datë 02.12.2020 në KQZ, në ora 10:30, tre ditë pas mbajtës së zgjedhjeve dhe kjo është në kundërshtim me rregullat dhe procedurat e PZAP-it. Në kundërshtim me afatin e paraparë prej 24 orëve, për parashtrimin e ankesës nga momenti i ndodhjes së shkeljes së supozuar zgjedhore, siç e parasheh edhe neni 5.5 i Rregullës Zgjedhore nr.02/2015, dhe do duhej të hedhet poshtë ankesa nga PZAP-i, sipas nenit 6.4 të Rregullës Zgjedhore nr.02/2015. Po ashtu në përgjigje ne ankese theksohet se është e papranueshme që procedura për shkeljen e rregullave zgjedhore iniciohet, ndërsa parashtruesi i ankesës nuk i ka ofruar PZAP-it, dëshmitë për pretendimet e tij, e kjo është detyra e parashtruesit të ankesës në bazë të Rregullës Zgjedhore nr.02/2015 në nenin 8.8 i cili parasheh se “ Përgjegjësia e ofrimit të provave është e palës cila e parashtron ankesën ”. Me tutje theksohet se deklarata të cilën e ka dhënë për media Kryetari i Listës Serbe Goran Rakic dhe të tjerët nga përfaqësuesit të Listës Serbe është dhënë me propozimin e gazetareve dhe me qëllim që të emitohet pas mbylljes së vendotimeve, gjë e cila shihet qartë nga video materiali të cilin ja u dorëzojmë me këtë rast. Me propozim për panelin që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, ka gjetur dhe ka vërtetuar se kryetari i Subjektit Politik Lista Serbe Goran Rakiq, me qëllim të promovimit të subjektit të tij politik dhe kandidatit të tyre, për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut, gjatë ditës së votimit, me datën 29.11.2020, ka bërë thirrje publike përmes mediave qytetareve të Komunës së Mitrovicës së Veriut, që ta votojnë kandidatin për kryetar të kësaj Komune, nga Subjekti Politik Lista Serbe, me numër 123 Milan Radojevic, duke theksuar se Subjekti Politik Lista Serbe dhe kandidati në fjalë e kanë përkrahjen nga Serbia dhe Presidenti Vucic.

Lidhur me pretendimet në përgjigje në ankese të Subjektit Politik Lista Serbe, se në ditën e heshtjes zgjedhore se nuk ka organizuar asnjë konference dhe nuk ka të dhëna se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar. Paneli vlerëson se këto pretendime janë të paqëndrueshme sepse me ankesë nuk pretendohet se është organizuar konferencë për media, mirëpo Kryetari i Subjektit Politik Lista Serbe dhe pjesëtar tjerë të këtij subjekti në ditën e votimit të datës 29.11.2020, përmes mediave i është adresuar qytetarëve të vendit që të dalin masivisht në zgjedhje si obligim qytetar, të respektojnë masat për mbrojtje nga Covid-i, ndërsa ta përkrahin kandidatin e Listës Serbe, pasi përkrahjen që ata e kanë nga Shteti i Serbisë dhe presidenti Vucic sot duhet ta tregojnë përmes votimit të kandidatit nga ky subjekt.

Ky fjalim është përcjellë nga mediat shqiptare dhe ato serbe dhe ka qenë fjalim publik përmes adresimit në ditën e votimit, sikurse liderët që i adresohen në vazhdimësi elektoratit për të dalë në zgjedhje, e kjo ka ndodhë në fazën e periudhës së heshtjes zgjedhore deri në mbylljen e votimeve, ka bërë thirrje publike përmes mediave të votohet subjekti politik Lista Serbe, siç konstatohet nga video-incizimet të cilat janë emituar në të gjitha televizionet e Kosovës, shihet qartë se kryetari i subjektit politik gjatë ditës së zgjedhjeve në prezencë të gazetarëve bënë thirrje që të votohet kandidati për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut nga ky subjekt politik, fakte këto të njohura botërisht e të cilat nuk është e nevojshme të provohen duke u mbështetur në nenin 321 paragrafi 1 të Ligjit Procedurës Kontestimore (LPK).

Nuk qëndron pretendimi në përgjigje në ankesë rreth afatshmërisë së ankesës së subjektit politik VV, pasi ankesa është dorëzuar përmes postës dhe data e dorëzimit në postë llogaritet data e ushtrimit të ankesës, ndërsa nga vula e pranimit në postë rezulton se është data 30.10.2020 pra brenda afatit 24 orë, nga koha e shkeljes së pretenduar dhe jo data e pretenduar me përgjigje në ankesë data 02.12.2020.

Sa i përket pretendimeve të Subjektit Politik Lista Serbe, se ankesa është ushtruar me datë 02.12.2020, në KQZ, në ora 10:30, tri dite pas mbajtjes së zgjedhjeve, Paneli vlerëson se këto pretendime janë të pa qëndrueshme ngase ankesa është dorëzuar në Postën e Kosovës, me datë 30.10.2020, siç konstatohet nga vula e pranimi në postë, e që rezulton se ankuesi brenda afateve ligjore ka paraqitur ankesë.

Nga përgjigja në ankesë e Listës Serbe, Paneli gjeti se subjekti politik se Kryetari i Listës Serbe Goran Rakiqi dhe anëtari Igor Simiq, gjatë ditës së votimit kanë dhënë deklaratë para mediave me një marrëveshje me gazetaret që e tëra kjo të transmetohet pas orës 19:00, pra pas mbylljes së vendvotimeve. Andaj me këtë rast Paneli, vlerëson se ka ndodhur thyerja e heshtjes zgjedhore.

Paneli, vlerëson se në veprimet e Kryetarit të Subjektit Politik Lista Serbe por edhe zyrtarit tjetër të këtij subjekti Igor Simic, që të dy funksionar publik në Qeverinë respektivisht Kuvendin e Republikës së Kosovës, pra me pozitë të Ministrit dhe deputetit janë përmbushur elementet e shkeljes së kodit zgjedhor përmes thyerjes së heshtjes zgjedhore.

Heshtja zgjedhore nënkupton pasivizimin e subjekteve politike, mediave dhe të gjithë akterëve tjerë në raport me promovimin, thirrjen apo elemente tjera të propagandës zgjedhore në raport me një subjekt politik, pasi në këtë mënyrë qytetarit i garantohet periudhë kohore e reflektimit dhe vendimit të përcaktimit të tij për votimin.

Adresimi i zakonshëm para mediave siç është bërë praktikë e rëndomtë e të gjitha shteteve demokratike për nxitje, për të votuar në mënyrë të lirë dhe masovike është keqpërdorur nga kryetari i subjektit garues përmes thirrjes së hapur të qytetarëve se për kënd duhet të votohet, pasi kjo nënkupton kthim të borxhit në raport me mbështetjen që kanë marr nga shteti i Serbisë dhe Presidenti Vucic, cenon rëndë lirinë e përcaktimit të qytetarit me rastin e votimit. Cenimi i lirisë së votimit përmes thirrjes publike paraqet tendencë për ndërhyrje të pastër në proces zgjedhor, përmes përçimit të mesazhit të frikësimit dhe kështu e drejta e votimit të lirë cenohet. Kur veprimeve të kryetarit të Listës Serbe, ia shtojmë faktin se ai si ministër me funksion publik në Qeverinë Republikës së Kosovës në mënyrë të hapur fton për votim të kandidatit të kësaj liste, përbën kërcënim indirekt të qytetarit se çfarëdo përcaktimi tjetër përveç për kandidatin e këtij subjekti nënkupton humbje të mbështetjes nga shteti i Serbisë dhe presidenti i këtij Shteti Aleksandër Vucic, por edhe humbje e përkrahjes nga përfaqësuesit e këtij subjekti brenda Qeverisë së Kosovës.

Në këtë rast Paneli, vlerëson se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit Të Mirësjelljes Për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre Dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit, ku përcaktohet se 24 orë, para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Me nenin 120 paragraf 1 pika c) të LZP-së, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, me nr. 03/ L-073, neni 14, përcaktohet se: " neni 120 në fuqi paragrafi 1 pika b) dhe c), riformulohen si në vijim: pika c), të vendosë një gjobë një subjekti politik në vlerë deri 50,000 euro ".

Me nenin 6 paragrafi 2 i Rregullores Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, përcaktohet se: " Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë fushatë në çfarëdo mënyre njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit, për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, i shqiptohet gjoba subjektit politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me gjashtëmijë e pesëqind (6, 500) euro, deri me njëzetepesëmijë (25.000) euro ".

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në

dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik Lista Serbe, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, e aq më tepër thyerja e heshtjes zgjedhore në këtë rast është bërë nga vet kryetari i këtij subjektit politik, e çka nënkuptohet se i njëjti ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit ligjore gjatë heshtjes zgjedhore, në një proces zgjedhor.
- Thirrja ka qenë e drejtuar qytetarëve nga personi që ushtron funksion publik në Qeverinë e Republikës së Kosovës.,
- Koha kur është ndërmarr veprimi në orët e mëngjesit, si paralajmërim se çfarëdo përcaktimi ndryshe nga ai që fton ky person dhe subjekt politik, të drejtat e serbëve të Kosovës humbin përkrahjen e shteti të Serbisë dhe presidentit të këtij shteti Aleksandër Vuçiq,
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga gjuha e tillë dhe veprimet që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lista Serbe, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1 pika b) i LZP-së, neni 6 paragrafi 2 i Rregullores Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, neni 118 paragraf 1, neni 117 paragrafi 3 dhe neni 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të KZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e KZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga KZAP-i. ”

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.1/2020 më datën 04.12.2020

Kryesuesi i Panelit
Rrustem Thaçi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.